



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE Durrës

Nr. _____ prot

Durrës, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS “Blerje materiale për rrethimin e vend depozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44334000-0

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 67837-11-06-2025

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.995.680 (një milion e nenetëqind e netedhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 26, nenit 27, 28, 29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së

nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tre) viteve te fundit (2022, 2023, 2024). Kur kërkesat për paraqitje të balanceve për 3 (tre) vitet te fundit nuk mund të plotësohet për arsye objektive si në rastin e operatoreve ekonomik te sapokrijuar, ky kriter quhet i plotësuar me paraqitjen e bilancit/ve te fundit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”e ndryshuar, nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve.

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet te pershtatshem per transport te mallrave objekt prokurimi, per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e te gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet: *“1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me originalin...”*

4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese ne SPE Deklarate ne te cilen te mare persiper permbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar per çdo produkt sipas kerkesave te AK si dhe realizimin e kontrates sipas afatit 20 ditor.

Argumentim: Ne baze te nenit 36 te ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar nëse operatori ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas kerkesave dhe specifikimeve.

5. Ofertuesit duhet te paraqesin

- a. Ofertuesit duhet te paraqesin Çertifikate Personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga

Republika e Shqipërisë. **Ne Çertifikate personale ISO 9001:2015 duhet të jete e perfshire Objekti i prokurimit.**

b. Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate Personale ISO 3834-2:2021, për sigurimin e cilësive në proceset e saldimit dhe /ose të njevlëshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

Kriteri që OE duhet të disponojë Çertifikate ISO 9001: 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente me të, ”Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së furnizimit me mallra që ofron.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Zbatimi dhe certifikimi i sistemit të menaxhimit të cilësive sjell besim tek partneret e biznesit dhe autoritetet në lidhje me produktet dhe shërbimet furnizuese duke ndihmuar për zvogëlimin e humbjeve dhe përmirësimin e efikasitetit të biznesit në teresi.

Kriteri që OE duhet të disponojë Çertifikate ISO 3834-2:2021 për sigurimin e cilësive në proceset e saldimit dhe /ose të njevlëshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar, është në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa teknike dhe standarde të cilësisë që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që synojnë garantimin e përmbushjes me cilësi të lartë të punimeve, furnizimeve apo shërbimeve. Sipas nenit 45 të ligjit të sipërpërmendur, specifikimet teknike mund të referohen ndaj standardeve kombëtare, ndërkombëtare ose ekuivalente të tyre, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe të përputhshmërisë me kërkesat e sigurisë dhe performancës. Në këtë kuadër, kërkesa për zbatim të standardit ISO 3834-2:2021 për sigurimin e cilësive në proceset e saldimit dhe /ose të njevlëshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar që garanton të njëjtin nivel sigurie dhe cilësie, është plotësisht e bazuar ligjërisht dhe teknikisht. Arsye teknike pse kërkohej kjo është se proceset e saldimit përbëjnë një fazë kritike në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e strukturave metalike, pajisjeve dhe instalimeve teknike. Cilësia e saldimit ndikon drejtpërdrejt në: sigurinë strukturore të objekteve publike; jetëgjatësinë e produktit; shfaqjen e defekteve dhe ndërhyrjeve të kushtueshme; përputhshmërinë me standardet evropiane për sigurinë teknike. Standardi ISO 3834-2 përcakton kërkesa të plota për: kualifikimin e saldatorëve dhe procedurave të saldimit; kontrollin e materialeve dhe pajisjeve;

inspektimet para, gjatë dhe pas procesit të saldimit; dokumentimin dhe gjurmueshmërinë teknike të çdo faze të punës.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht një saldator me çertifikatë profesionale. OE duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

- Kontraten e punës sipas legjislacionit.
- Çertifikatën Profesionale të lëshuar nga organet kompetente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 45, të ligjit Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.


Kjo kërkesë bazohet në dispozitat e nenit 45 të Ligjit Nr. 162/2020, i cili përcakton se autoriteti kontraktor ka të drejtë të vendosë kriteret e aftësisë teknike dhe profesionale që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë, me qëllim që të garantohet kryerja me cilësi e kontratës publike.

Në pikën 2, gërma “b” të këtij neni, përcaktohet se operatori ekonomik duhet të demonstrojë se ka personel teknik dhe profesional të kualifikuar, me përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Gjithashtu, në përputhje me nenin 3 të po këtij ligji, një nga qëllimet bazë të prokurimit publik është sigurimi i përdorimit efikas të fondeve publike, duke garantuar që punimet, mallrat apo shërbimet të kryhen me cilësi dhe standarde profesionale. Në këtë kontekst, kërkesa për të pasur një saldator të punësuar dhe të certifikuar profesionalisht është një element thelbësor për të siguruar se operatori ekonomik disponon kapacitetet njerëzore dhe teknike të nevojshme për përmbushjen me cilësi të kontratës. Proceset e saldimit kërkojnë njohuri specifike teknike dhe respektim të standardeve të sigurisë, ndaj personeli duhet të jetë i kualifikuar dhe i pajisur me çertifikatë profesionale të lëshuar nga organet kompetente. Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare dhe standardet ISO 3834-2:2021 për sigurimin e cilësisë në proceset e saldimit dhe /ose të njevelefshme.

7. Operatori ekonomik ofertues, në ditën e hapjes së ofertave (perpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të protokolluara një mostër të paraqesë mostrat e produkteve si më poshtë:

Nr	Emertimi i Mallit	Sasia
1	Profil Kemb TI	1
2	Profil Kembe Kend	1
3	Ptprofil perforcues	1
4	Lamarin balllore	1
5	Llamarine anesore	1
6	Bulona kok çader Ø 8	1
7	Dado exagonale me frenues najloni për bulona kok çader Ø 8	1
8	Upa ekspres Ø 12	1

1. Profil Kembe TI




Profili duhet te jete δ 2.5


Baza duhet te jete δ 8

2. Profil Kembe KEND

2




155 cm



Profili duhet te jete δ 2.5


Baza duhet te jete δ 8

3. Profil perforcues



Profili duhet te jete δ 2.5


4. Lllamarin ballore



Lllamarina duhet te jete δ 2.5

4.1 Kthimi i llamarines


4



Kthimi llamarines

5. Llamarine anesore


5



Llamarina duhet te jete δ 2.5


6. Bulona kok çader Ø 8

7. Dado ekzagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8



8. Upa ekspres Ø 12+ Dado ekzagonale me frenues najloni

8



Upa Express metalike $\phi 12$

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.


Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar, në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin në Ligjin 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pikat 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa prej produkteve objekt prokurimi...”Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi përparaqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

SPECIFIKIME PER “BLERJE MATERIALE PER RRETHIMIN E VEND DEPOZITIMEVE TE MBETJEVE URBANE ME KONSTRUKSION METALIK”

Specifikime:


1. Profil Kembe TI



Profil duhet te jete δ 2.5

Baza duhet te jete δ 8

2. Profil Kembe KEND




Profili duhet te jete δ 2.5

Baza duhet te jete δ 8

3. Profil perforcues


3



Profili duhet te jete δ 2.5

4. Llamarin ballore


4



Llamarina duhet te jete δ 2.5

4.1 Kthimi i llamarines


4



Kthimi lamarines

5. Llamarine anesore

5




Llamarina duhet te jete δ 2.5

6. Bulona kok çader Ø 8

7. Dado ekzagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8


6 + 7



+ Bulon - Ø 8
Dada


8. Upa ekspres Ø 12+ Dado ekzagonale me frenues najloni

8




Upa ekspres metalike $\phi 12$


9. Montim ne terren i kollonave me llamarinat




Montimi i kllones kend



Montimi i kllones TI



Montimi i profilit perforcues



Montimi final

- Materiali duhet te jete i gjithi i xinguar
- Materiali duhet te jete i gjithi i lyer me boje puder elektrostатike, ne furre me pjekje
- Kthimet, Prarjet, Shpimet e vrimave, saldimit dhe çdo punim tjetër mbi material duhet te behet perpara xingimit dhe lyerjes
- I gjith materiali te jete i amballazhuar per te eliminuar gerrvishjet.
- Bulonat dhe dadot te jene te paketuara
- Ngjyra do te percaktohet nga AK

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.